



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Gusht 2016

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Gusht 2016

© Ministria e Financave, 2016

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: eva.doda@financa.gov.al
vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin gusht 2016 arriti në 101.1 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin gusht 2016 ishte 2.0 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin gusht 2016 ishte 121.79 lekë për dollarë dhe 136.51 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit gusht 2016 shënuan kuotat 0.54 për qind për ato 12-mujore, 0.67 për qind për 6-mujoret ,0.29 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.57 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 7.57 për qind për huatë 12-mujore dhe 11.04 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,231,200.7 milionë lekë në muajin gusht, duke shënuar një rritje prej rreth 2.3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e dytë të 2016-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 0.
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-gusht 2016 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 13.7 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 1.8 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 11.8 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-gusht 2016, arritën në rreth 265.7 miliardë lekë ose afërsisht 99 për qind e planit për muajin gusht.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 252.0 miliardë lekë ose 98 për qind e shpenzimeve të planifikuara për muajin gusht.


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin gusht 2016 ishte +2.0 %. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 1.9%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin gusht 2016 shënoi rritje prej 0.9 për qind krahasuar me muajin korrik 2016. Ky indeks ka shënuar rritje prej 0.05 në muajin korrik. Ndërsa në muajt qershor, maj dhe prill ky indeks ka shënuar rënie respektivisht prej 0.6; 1.2 dhe 0.4 krahasuar me muajin paraardhës. Një vit më parë ky indeks ka pasur tendencë rritje për muajt gusht me përkatisht 0.8 për qind.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.7%, duke kontribuar me +1.70 pikë përqindje; Shërbimi arsimor” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.4%, duke kontribuar me +0.17 pikë përqindje; “Argëtim dhe kulturë” me një rritje vjetore të çmimit prej +2.4%.



Kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Transport” me një rritje vjetore të çmimit prej -2.2%, duke kontribuar me -0.14 pikë përqindje; “Veshje dhe këpucë” me një rritje vjetore të çmimit prej -0.4%, duke kontribuar me -0.01 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.0%.

Ndryshimi mujor i indeksit është +0.9 %. Krahasuar me muajin Korrik 2016, rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,3 %.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2015	1.3	2.3	2.2	2.3	1.8	1.4	1.3	1.9	2.2	2.1	2.1	2.0
2016	1.5	0.2	0.3	0.3	0.7	1.2	1.9	2.0				

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin gusht 2016, arriti në 136.51 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.04 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit gusht, një euro u këmbye me 137.52 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin gusht 2016 arriti në 121.79 lekë/dollarë duke shënuar rënie me 1.3 për qind kundrejt muajit korrik 2016. Në fund të muajit gusht, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 123.34 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin gusht të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 2.9 për qind, ndërsa kundrejt monedhës evropiane rezulton se është nënçmuar në masën 2.2 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës amerikane dhe evropiane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.8 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave


Gjatë muajit gusht 2016, normat e interesit të depozitave 12 dhe 6-mujore në lekë arritën kuotën e 0.54 dhe 0.67 për qind duke shënuar respektivisht rënie prej 0.16 dhe rritje 0.09 pikë përqindje krahasuar me muajin korrik 2016. Normat e interesit të depozitave me afat të maturimit 3-mujore arritën kuotën 0.29 për qind, ndërsa ato me afat maturimi 1-mujore shënuan rënie prej 0.14 pikë përqindje duke arritur nivelin 0.57 për qind.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1-mujore. Rënia më e madhe prej 0.78 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 1-mujor që kanë arritur nivelin 0.57 për qind për gusht 2016, pasuar nga depozitat me afat të maturimit 12-mujor me rënie vjetore prej 0.50 pikë përqindje.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit gusht 2016 shënoi rritje me 0.41 pikë përqindje krahasuar me muajin korrik 2016, duke arritur në nivelin 7.57 për qind. Norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rritje me 1.74 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë duke arritur nivelin 11.04 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit gusht 2016, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 1.46 dhe 0.84 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie mujore në *yield*-in e bonove të thesarit 6-mujore dhe 1-mujore me 0.01 dhe 0.88 pikë përqindje.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë



4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2016 shënoi rritje të mjeleve valutore, me rreth 0.03 milionë euro. Tremujori i dytë i 2016-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej 354 milionë euro, rreth 2 herë më i lartë referuar të njëjtës periudhë në një vit më parë. Në krahasim me një vit më parë, deficitin e tregtisë së mallrave u thellua me tej me 39% duke arritur në 677 milionë euro. Flukset e kapitalit, shumën e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 246.4 milionë euro ndikuar kryesisht nga rritja e detyrimeve financiare ndaj jo rezidentëve (307 milionë euro). Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Llogaria korrente për tremujorin e dytë të vitit 2016 thelloi deficitin e saj në rreth 354 milionë euro, ose 2 herë më të larta referuar tremujorit të dytë në vitin 2015. Thellimi i deficitit korrent i atribuohet tërësisht zgjerimit të deficitit tregtar në mallra, me rreth 189 milionë euro ndërkohë që, përbërësit e tjerë të llogarisë korrente shënuan ndikime të papërfillshme. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente prej 258 milionë euro shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për vitin 2016:


- (i) bilanci tregtar me -677.1.1 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 121.9 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 15.2 milionë euro,
- (iv) transfertat neto me 216.6 milionë euro.

Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit gusht 2016, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 76,784 miliardë lekë krahasuar me muajin gusht të vitit 2015. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 45,152 miliardë lekë dhe të Bankës së Shqipërisë me rreth 31,632 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,231,200.7 milionë lekë në muajin gusht, duke shënuar rritje prej rreth 2.3 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në muajin gusht 2016, sistemi bankar rezulton me një rënie prej 17,342.5 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin korrik 2016.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin gusht 2016 arriti në 550,514 miliardë lekë. Teprica e kredisë, krahasuar me muajin gusht 2015 shënoi rënie me vlerë 577,0 miliardë lekë, pra rënie prej rreth 0.1 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 54.4 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 299,530 milionë lekë.

Gjatë muajit gusht 2016, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 64.4 për qind ose 354,560 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 29.0 për qind ose 158,885 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.9 dhe 1.68 për qind apo 26,975 dhe 9,224 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin gusht 2016, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 52.72 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 36.14 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.20 për qind dhe rreth 22.76 për qind.



7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin gusht 2016 shënoi rritje me 0.1 për qind krahasuar me muajin paraardhës korrik 2016. Kjo ofertë arriti në rreth 236,137.4 milionë lekë në fund të muajit gusht 2016, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin gusht 2015 prej 0.18 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin gusht 2016, kanë pësuar rënie prej 15,145.2 milionë lekë në krahasim me muajin gusht 2015. Depozitat në valutë gjatë muajit gusht 2016 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 82.8 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë, sektori i individëve ka zënë rreth 86.6 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit gusht 2016, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 86.6 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 10.3 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 2.0 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 82.8 për qind dhe rreth 14.9 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 84.6 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 842,013.6 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (125,859.4 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (14,604.4 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (10,378.9 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 2,207.1 milionë lekë në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Gusht 2016

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit gusht 2016, niveli i përgjithshëm i depozitave krahasuar me një muaj më parë, shënoi rritje prej 15,115.1 milionë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar gjithashtu rritje me 20,199 milionë lekë.


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-gusht 2016 janë mbledhur rreth 265.7 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 252.0 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 223.2 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 28.8 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 58% janë financime të brendshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 181.6 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 10.2 miliardë lekë (ose rreth 102% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 51.4 miliardë lekë (ose rreth 99% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 15.9 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit të periudhës janar-gusht).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 223.2 miliardë lekë, 44.5 miliardë lekë (19.9% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 23.4 miliardë lekë (10.5%) për interesat, 23.5 miliardë lekë (10.5%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 973 milionë lekë (0.4%) për



subvencione, 94.3 miliardë lekë (42.2%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 22.4 miliardë lekë (10.0%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 12.8 miliardë lekë (5.7%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 63% (shpenzime personeli), 55% (shpenzime për interesat), 54% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 56% (subvencione), 63% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 46% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 55% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 49%, ndërsa financimi i huaj është 50% e planifikimit të tyre vjetor..

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-gusht 2016 ishin rreth 265.7 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 244.5 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 15.9 miliardë lekë.

Tab - 2

*Të ardhurat gjatë periudhës Janar-Gusht 2016 (mld Lekë)
Revenues during January-August 2016 (in billion ALL)*

Burimi (Source)	Gusht '16 August '16	Gusht'15 August'15	Ndrysh(%) Chang (%)
TVSH (VAT)	85.6	80.2	9.4
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	19.8	16.6	18.8
Taksa doganore (Custom Tax)	3.9	3.7	6.5
Taksat nacionale (National Tax)	20.8	19.0	9.3
Akcizat (Excise)	27.5	25.9	6.2
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	22.0	19.5	12.9

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Gusht – 2016;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: August – 2016;

1. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 13.7 miliardë lekë, përgjatë periudhës janar-gusht 2016, u përdor kryesisht për pagesën e maturimit të huamarrjes së brendshme (rreth 207% të totalit të suficitit) dhe nëpërmjet huasë afatgjatë të huaj (rreth 76% të totalit të suficitit).

Për muajin gusht 2016, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 32.564 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 36.104 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin gusht 2016, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 31.2 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 30.9 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.1 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1																			
Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	
Janar	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	0.9	0.80	0.7	1.00	0.8	1.4	0.9	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	1.5	January
Shkurt	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4	1.1	1.55	1.0	1.05	1.1	1.9	1.0	4.5	0.6	2.5	1.9	2.3	0.2	February
Mars	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.4	0.5	1.00	0.8	0.77	0.9	1.4	0.7	4.3	1.0	2.4	2.2	2.2	0.3	March
Prill	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	-0.4	0.60	0.6	0.55	0.5	0.9	0.5	4.1	1.6	2.3	1.7	2.3	0.3	April
Maj	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	-1.2	0.26	0.3	0.24	0.2	0.3	0.2	4.2	1.9	2.1	1.6	1.8	0.7	May
Qershor	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	-0.6	0.04	0.1	0.15	0.1	0.1	0.04	3.9	2.2	2.3	1.5	1.4	1.2	June
Korrik	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7	0.05	-0.07	0.1	-0.03	0.0	0.1	-0.10	3.6	2.7	1.6	1.8	1.3	1.9	July
Gusht	0.3	0.4	-0.1	0.1	0.8	0.86	-0.02	0.1	-0.04	0.0	0.1	-0.15	3.1	2.8	1.2	2.0	1.9	2.0	August
Shtator	0.4	0.2	0.8	0.3	0.6		0.02	0.1	0.06	0.0	0.2		2.8	2.6	1.7	1.5	2.2		September
Tetor	0.4	0.2	0.1	0.1	0.01		0.06	0.1	0.05	0.0	0.2		3.0	2.4	1.7	1.4	2.1		October
Nëntor	0.1	0.2	-0.5	-0.2	-0.3		0.06	0.1	0.01	0.0	0.1		2.9	2.5	1.0	1.7	2.1		November
Dhjetor	1.0	0.9	1.7	0.7	0.6		0.14	0.2	0.15	0.1	0.17		1.7	2.4	1.9	0.7	2.0		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2011	2012	2013	2014	2015	2016							Gusht	Currency
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik		
<i>Mesatarja e periudhës</i>														
USD	100.90	108.18	105.67	113.64	126.64	127.37	124.70	124.56	122.21	122.35	122.76	123.37	121.79	USD
EURO	140.33	139.04	140.27	140.11	137.65	138.35	138.33	138.22	138.51	138.32	137.92	136.57	136.51	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>														
USD	107.54	105.85	101.86	115.23	125.79	127.06	126.59	122.26	121.56	124.15	123.50	122.60	123.34	USD
EURO	138.93	139.59	140.20	140.14	137.28	138.68	138.24	138.77	138.29	138.32	137.33	136.18	137.52	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2011	2012	2013	2014	2015	2016							Gusht August	In percent
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor June	Korrik July		
Norma e depozitave														
12-M	5.87	5.38	4.17	1.51	1.27	1.18	1.15	1.07	0.93	0.84	0.73	0.70	0.54	12-M
6-M	4.87	4.50	3.40	1.16	1.17	0.90	0.74	0.78	0.65	0.67	0.54	0.58	0.67	6-M
3-M	4.22	3.83	2.72	0.83	0.54	0.50	0.51	0.39	0.33	0.29	0.28	0.28	0.29	3-M
1-M	4.39	3.62	2.79	1.47	0.88	1.14	0.56	0.49	0.72	0.67	0.72	0.71	0.57	1-M
Norma e huasë														
12-M	11.17	10.28	9.52	7.00	7.47	8.29	7.31	7.47	4.29	8.30	7.19	7.16	7.57	12-M
6-M	12.28	10.61	9.59	8.18	8.35	9.24	9.48	9.28	9.67	9.79	10.08	9.30	11.04	6-M
Norma e letrave me vlerë														
Bono thesari 1/														
3-M	5.31	5.03	3.40	3.15	-	1.45	-	-	0.90	-	-	0.88	-	3-M
6-M	6.23	5.65	3.54	3.16	2.46	1.99	1.36	1.26	1.15	0.99	0.95	0.94	0.84	6-M
12-M	6.95	6.37	3.66	3.33	2.40	2.10	1.78	1.63	1.52	1.35	1.28	1.29	1.46	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2016

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	32,829	61,725	96,639	131,304	164,324	198,316	233,202	265,766	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	335	1,655	2,542	3,303	3,895	4,149	5,189	5,320	Grants
II.	Të ardhura tatimore	29,799	55,728	88,166	119,583	150,151	180,716	213,224	244,517	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	21,355	40,944	66,560	88,241	110,315	133,672	157,489	181,672	tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,195	19,861	29,912	40,474	51,357	62,830	74,104	85,652	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,556	3,416	10,787	12,814	14,551	16,522	18,113	19,821	Profit Tax
3	Akcizat	2,789	5,561	8,588	11,967	15,385	19,201	23,407	27,565	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,345	5,752	7,967	10,553	13,429	16,022	19,031	22,072	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,072	5,546	7,999	10,659	13,286	16,200	19,401	22,599	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	398	808	1,307	1,774	2,307	2,852	3,433	3,963	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	643	1,202	2,217	4,193	6,784	8,125	9,137	10,230	venues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	193	351	650	1,438	2,316	2,880	3,196	3,530	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	74	170	431	493	519	543	554	558	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	376	681	1,136	2,262	3,949	4,702	5,387	6,142	Local Taxes
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	7,801	13,582	19,389	27,149	33,052	38,964	46,598	52,615	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	6,551	11,371	16,242	22,714	27,677	32,704	39,098	44,196	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	1,144	1,895	2,630	3,752	4,556	5,326	6,429	7,207	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	106	316	517	683	819	934	1,071	1,212	as for property compensation
III.	Të ardhura Jotatimore	2,695	4,342	5,931	8,418	10,278	13,451	14,789	15,929	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	1,095	1,095	1,095	1,095	1,095	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,006	3,113	4,223	5,490	6,923	9,423	10,279	10,992	ome of budgetary institutions
3	Dividenti	0	2	2	10	11	21	23	70	Divident
4	Tarifat shërbimeve	513	653	788	1,004	1,155	1,346	1,590	1,748	Tariffs on services
5	Të tjera	176	574	918	819	1,094	1,568	1,802	2,024	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	23,898	51,678	83,547	116,144	146,727	182,129	216,081	252,038	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	22,490	48,531	75,313	103,951	131,644	162,021	192,303	223,218	Current Expenditures
I.1	Personeli	5,430	10,918	16,463	22,061	27,622	33,228	38,915	44,553	Personnel expenditures
1	Paga	4,657	9,376	14,148	18,965	23,755	28,573	33,490	38,355	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	773	1,542	2,315	3,096	3,867	4,655	5,425	6,198	ocial insurance contributions
I.2	Interesat	3,305	6,576	9,282	12,174	14,776	17,451	20,561	23,474	Interest
1	Të Brendshme	2,481	5,105	7,338	9,572	11,715	13,819	16,158	18,466	Domestic
2	Të Huaja	824	1,471	1,944	2,602	3,061	3,632	4,403	5,008	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,204	3,752	6,528	9,376	12,362	16,535	20,213	23,561	perational & Maintenance
I.4	Subveconet	54	100	273	339	417	631	811	973	Subsidies
I.6	Shpenzime për fonde speciale	10,264	21,510	32,856	44,843	56,958	69,347	81,575	95,397	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	8,332	16,643	25,362	34,245	43,089	52,478	62,056	72,293	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	1,932	4,669	7,296	10,400	13,434	16,434	19,084	22,013	Health insurance
3	Fondi i kompensimit te pronareve	0	198	198	198	435	435	435	1,091	as for Owners Compensation
I.7	Shpenzime per Buxhetin Vendor	1,399	3,365	5,729	9,122	11,761	15,366	19,002	22,404	Local budget expenditure
I.8	Shpenzime të tjera	834	2,310	4,182	6,036	7,748	9,463	11,226	12,856	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	41	85	133	188	262	334	406	471	ployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	801	1,956	3,782	5,552	7,002	8,615	10,125	11,507	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	-8	269	267	296	484	514	695	878	tion for ex-political prisoners
III	Shpenzime Kapitale	1,408	3,147	8,234	12,193	15,083	20,108	23,630	28,820	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	46	474	4,020	6,247	7,825	10,749	12,707	16,705	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,362	2,673	4,214	5,946	7,258	9,343	10,923	12,115	Foreign financed
V.	DEFICITI	8,931	10,047	13,092	15,160	17,597	16,187	17,268	13,728	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-8,931	-10,047	-13,092	-15,160	-17,597	-16,187	-17,268	-13,728	ih BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-9,154	-19,525	-22,154	-19,814	-26,455	-25,947	-26,823	-28,448	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	204	207	358	364	385	2,609	2,611	2,612	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,503	3,818	5,249	9,435	13,920	14,017	13,703	12,456	omestic new borrowing (net)
2.1	Nacionale	2,513	3,835	5,273	9,467	13,934	14,036	13,731	12,488	Other
2.2	Lokale	-10	-16	-24	-32	-14	-19	-28	-32	Foreign
3	Të tjera	-11,861	-23,550	-27,761	-29,613	-40,760	-42,573	-43,137	-43,516	Other
4	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-499	-14,410	-11,935	-16,301	-30,275	-29,535	-31,135	-32,107	positions into the Central Bank
5	Të tjera	-11,362	-9,140	-15,822	-13,312	-10,487	-12,887	-12,002	-11,409	Other
6	Depozita e ISSH dhe ISKSH	-2,759	-1,391	-4,083	-4,595	-4,261	-4,681	-3,940	-4,015	Socila and Health insurance
7	Mjete në ruajtje	-187	-93	-253	-649	1,590	-566	-828	-730	Preservation stock
8	Nënhua	94	160	269	654	755	1,064	1,166	1,220	On-Loan Principal
9	Detyrim ndaj ISSH	660	1,725	-287	1,152	934	8	2,219	-3,241	Liabilities to SSI
10	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-432	-544	-568	-586	-600	6	0	12	Other-Floot
V.3	I huaj	223	9,062	9,062	4,654	8,858	9,760	9,555	14,720	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	4,210	3,040	3,879	4,992	5,907	8,345	9,387	10,410	om foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua	242	418	857	1,128	984	3,438	3,872	4,166	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-3,182	-2,020	-1,983	-1,860	-2,054	-2,496	-2,832	-2,785	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-805	-1,584	-2,876	-8,520	-10,021	-12,283	-13,194	-14,031	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	0	10042	10042	10042	15026	16194	16194	21126	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

*Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2016

Table of investments 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	
Financim i brendshëm	46	474	4,020	6,247	7,825	10,749	12,707	16,705	Domestic financing
Në %	3.27	15.06	48.82	51.23	51.88	53.50	53.77	57.96	In %
Financim i huaj	1,362	2,673	4,214	5,946	7,258	9,343	10,923	12,115	Foreign financing
Në %	96.73	84.94	51.18	48.77	48.12	46.50	46.23	42.04	In %
Totali	1,408	3,147	8,234	12,193	15,083	20,092	23,630	28,820	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2016 (CUSTOMS REVENUES 2016)
Të dhëna progresive (Progressive Data)
në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	
Taksë doganore	398	808	1,307	1,774	2,307	2,852	3,433	3,963	Customs Duties
